



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW**

**PSH. Nr. 404/17**

**PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT** i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, në përbërje prej: z. Nuhi Paqarizi - Kryetar, z. Goran Milenkovic – anëtar, z. Blerim Dina – anëtar, duke vendosur sipas kërkesës së parashtruar nga AK - Ministria e Shëndetësisë për diskualifikim të OE “Trio Med” – Prishtinë, sipas nenit 99.2 të LPP-së, më: 18.07.2017, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. Aprovohet**, si e bazuar, kërkesa e Autoriteti Kontraktues (AK) – /Ministria e Shëndetësisë/ – (MSH), e dt: 14.01.2015, për diskualifikim të operatorit ekonomik “Trio Med” – Prishtinë, nga pjesëmarrja në prokurim publik.
- II. Diskualifikohet**, operatori ekonomik “Trio Med” – Prishtinë, nga pjesëmarrja në prokurim publik, për periudhën gjashtëmuajore (6 muaj).

## ARSYETIM

Autoriteti kontraktues - Ministria e Shëndetësisë me datën: 12.06.2017, ka parashtruar kërkesë për shqiptimin e masës konform nenit 99.2 të LPP-se, ndaj OE "Trio Med", me arsyetimin se me rastin e aplikimit në aktivitetin e prokurimit: **"Furnizim me barna dhe material shpenzues medicinal nga lista esenciale"**, me numër të prokurimit: 206/16/103/111, i njëjti ka prezantuar dokumente të falsifikuara në ofertën e tij, konkretisht lidhur me certifikatën me numër: Q2N140781232003.

Gjatë seancës dëgjimore të mbajtur me datë: 18.07.2017, ku te pranishëm ishin, përfaqësuesit e AK – MSH-se si dhe përfaqësuesi i OE "Trio Med", paneli shqyrtues i shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës duke përfshirë kërkesën e AK-së të datës: 12.06.2017 me nr. 404/17, certifikatën me nr. Q2N140781232003 dhe pas dëgjimit të palëve, ku përfaqësuesi i OE "Trio Med" e kundërshton kërkesën dhe pretendimet e AK-së duke deklaruar se kjo certifikatë është zëvendësuar me një certifikatë tjetër dhe se certifikatën në fjalë e kemi pranuar në këtë formë nga prodhuesi me të cilin kemi ofertuar në këtë aktivitet të prokurimit dhe se nuk ka ndërhyrje në atë dokument.

Përfaqësuesi i AK – MSH-së, poashtu gjatë seancës dëgjimore, deklaroi se kërkesa jonë për marrjen e masave konform nenit 99.2 të LPP-së, ndaj OE "Trio Med" bazohet në konfirmimin e certifikuesit TUV – Gjermani, të cilët pas kërkesës tonë për verifikim të certifikatës se OE "Trio Med", kanë deklaruar, citoj: duke u bazuar në data bazën certifikata e lartcekur e prodhuesit "AnHui Hongyuiuzhou medical", është zëvendësuar me certifikatën Q2N150581232005 dhe njëherit përfaqësuesit e AK-së, gjatë seancës dëgjimore deklaruan se lidhur me këtë certifikatë organet e hetuesisë kanë filluar hetimet ku me datën: 09.06.2017, përmes kësaj shkrese me nr. 05-4374, të cilën e prezantojmë para jush, Policia e Kosovës ka kërkuar që të filloj hetimet lidhur me këtë certifikatë.

Paneli shqyrtues, duke pasur parasysh kërkesën e dt:13.06.2017 me nr.404/17 të UD Udhëheqësit të Divizionit të Prokurimit në Ministrinë e Shëndetësisë z. Alban Pozhegu konstaton se OE "Trio Med", në ofertën e tij origjinale e ka dorëzuar certifikatën me numër: Q2N140781232003 e cila e mban datën e skadimit: 19.07.2017.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në dëshmitë e prezantuara nga autoriteti kontraktues-Ministria e Shëndetësisë, sqaron se me dt:21.02.2017 përfaqësues të AK-së kanë kërkuar sqarime nga TUV SUD Product service GMBH në adresën Henrich, Jari Andre;Info-Konzern, në lidhje me certifikatën numër: Q2N140781232003, ndërsa me dt:06.04.2017 ka marr përgjigje ku është sqaruar se kjo certifikatë ka qenë valide prej dt:05.12.2014 deri me 19.08.2015.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në dëshmitë që ka pasur në dispozicion, të ofruara nga Ministria e Shëndetësisë konstaton se operatori ekonomik “Trio Med” – Prishtinë në aktivitetin e prokurimit “Furnizim me barna dhe material shpenzues medicinal nga lista esenciale”, me numër të prokurimit: 206/16/103/111 ka ofruar të dhëna të rreme në lidhje me certifikatën e lartpërmendur

Pasi që lidhur me këtë certifikatë janë duke u zhvilluar hetime nga Policia e Kosovës ashtu siç e ka cekur përfaqësuesi i AK-së në seancën dëgjimore, kjo masë-diskualifikimi, mund të revokohet para periudhës gjashtëmujore(6 muaj)në momentin kur Policia e Kosovës pas zhvillimit të hetimeve vërteton se nuk ka dyshime te falsifikim apo prezantimit te dokumentit te rrejshëm.

Paneli shqyrtues, duke u bazuar në nenin 117 të LPP-së, si dhe duke u mbështetur në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë Juridike :**

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur nuk mund të ushtron ankesë, por për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh, pas pranimit të këtij vendimi, mund të ngritë kërkesë-padi në Gjykatën Themelore - Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative.

Vendimi t’i dorëzohet:

1x1 AK –Ministrisë se Shëndetësisë

1x1 OE “Tri Med”

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Policisë së Kosovës – Departamentit për hetime të korrupsionit DHKEK – DPP – Prishtinë;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.

